



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KESHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 6 datë 29-1-2026

Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i buxhetit vendor për vitin 2026.

Duke u mbështetur në Ligjin nr.139, datë 17.12.2015, "Për vetë qeverisjen vendore", Ligjin nr. 9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026, Ligji nr.57/2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", neni 21, të Udhëzimeve nr. 3, 4, 5,8 datë 17.02.2017, pika 2, të Ministrit të Mirëqënies Sociale, V.K.M Nr.597, datë 04.09.2019, dhe Vendimit Nr.868, datë 29.12.2021 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndihmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike"i ndryshuar, Administratorët Shoqërorë të Drejtorisë së Kujdesit Social të Bashkisë Korçë, i propozojnë Këshillit të Bashkisë.

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1-Miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike , nga fondi i buxhetit vendor si më poshtë vijon:

Përfitues të fondit nga buxheti i Pushtetit Vendor do të jenë:

1. Familjet të cilat kanë aplikuar për Ndihmë Ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi i pikëzimit.
2. Familja para se të përzgjidhet për tu trajtuar me këtë fond, duhet të jetë verifikuar paraprakisht dhe do të vlerësohet nga Administratorët Shoqërorë.
3. Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jetë pa të ardhura .
4. Familje me k/familjarë të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë që ndjek arsimin bazë ose të lartë.

5. Familje të cilat kanë fëmijë në moshë madhore, me probleme të ndryshme sociale (përdorues të lëndëve narkotike, probleme me ligjin etj.) të cilët kanë vështirësi punësimi.
6. Familje rome-egjiptiane të cilat kanë probleme me transferimin dhe regjistrimin.
7. Familjet me një anëtar që nuk kanë të ardhura.
8. Familje me disa anëtarë në përbërje të së cilës ka anëtar mbi moshë pune përfitues të një pensioni pleqërie.
9. Familje në varfëri ekstreme në rast fatkeqësie në pamundësi të përballimit të shpenzimeve.
10. Rastet kur k/familjari ose edhe anëtarë të tjerë madhorë janë të paaftë për të punuar por për shkak të kritereve të komisionit biopsikosocial nuk përfitojnë pagesë Paaftësie.

2-Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet **Drejtorja e Kujdesit Social dhe Drejtorja e Financës, buxhetit dhe MFK**

3- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI



Miratuar me 27 vota
Vota Pro 27
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur më datë 29-1-2026

